



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

I	Data	04-05/18	Vendi
Org.	Numri	Shtojcë	
01/11-60/01-128-15/2018			

PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së IV (Katërt) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 27 Prill 2018.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e IV (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë : 27 Prill 2018, dhe atë:

1. Vendimi për aprovimin e Raportit Financiar për periudhën, Janar-Mars 2018;
2. Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Kaçanikut;
3. Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të Tregut të Gjellbër Ndërmarrjes Publike “ Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik;
4. Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;
5. Vendimi për dhënien e Pëlqimit, Organizatorit të Fondacionit “ Idriz Seferi” për gdhendjen në shkëmb të figurës – heroit kombëtar, Idriz Seferi të Gryka e Kaçanikut; dhe
6. Vendimi për Aprovimin e Plani i mbrojtjes nga zjarri për Komunën e Kaçanikut.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 05-400/01-12378/18
Kaçanik, 27.04.2018

Në bazë të nenit 40.2(b) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të nenit 34.5 dhe 61 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 56 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 Prill 2018, mori këtë:

V E N D I M
Për Aprovimin e Raportit Financiar
Janar-Mars 2018

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 05 400/01-12378/18 -- me tekstin e mëtejshëm " Raporti tre mujor Financiar, për periudhën : Janar-Mars 2018 , i hartuar nga Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048.
2. Në Raportin Vjetor Financiar të përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi, janë prezentuar Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave të parave të gatëshme të Buxhetit të Përgjithshëm të Komunës së Kaçanikut, për periudhën 01.01.2018-31.03.2018 dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe
3. Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kacanik

01 Nr. 06-350/02-12655/18
Kaçanik, 27. 04. 2018

Në bazë të nenit 17 pika (n) dhe (p) lidhur me nenin 40.2 (l) të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008) nenit 6.2 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të DUKMM 06-350/02-12655/18 prej datës 19.04.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 27 Prill 2018, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në menaxhim të përkohshëm, Tregun e Gjellbër, Ndërmarrjes Publike “ Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik

1. Me këtë Vendim, i jepet në menaxhim të përkohshëm, Tregu i Gjellbër, Ndërmarrjes Publike “Stacioni i Autobusëve” Sh. A- Kaçanik, deri në caktimin e lokacionit të ri.
2. Ndërmarrja Publike “Stacioni i Autobusëve”, Sh. A, do të mirëmbajë dhe inkasoj mjetet dhe jashtë ditës së tregut (e premtë) të shfrytëzohet si parking për automjete me pagesë.
3. Ecurinë e mirëmbajtjes së Tregut të Gjellbër e mbikëqyrë, Inspektorati komunal.
4. Mjetet e inkasuar shfrytëzohen nga N.P “ Stacioni i Autobusëve” Sh. A, e njëjta është e obliguar t'i paraqes Raport tremujor me shkrim, Kuvendit të Komunës.
5. Tarifat caktohen në bazë të Rregullores së Kuvendit të komunës së Kaçanikut.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave dhe Drejtoria e Ekonomisë , Financave dhe Zhvillimit.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) , Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA/IZVOD IZ CERTIFIKATA/EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA /PERSON : P.SH. KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	941-14836/18
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	08.05.2018 - 11:02
Komuna / Opština / Municipality:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistritit Drzava državljanstva ili uključenja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishmen t	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P.SH. KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK				KCID0900146	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			24.02.2016

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Azurirano Updated
KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK		EMIN DURA KU 2	KAÇANIK	24.02.2016



B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njesia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Zona kadastrale katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njesisë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type	Zona U/R Zone U/R	Kati/Katet Br./Sprat al/ Spratova Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Azurirano Updated
P-70917048-00568-2	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land			MOTEL / MOTEL / MOTEL	7668	Tokë Ndërtimore - Shtëpi-Ndërtëse - / Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradëvinsko zemljište - Kuca- Zgrada - / Gradëvinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - House-Building - / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posezim individual / Individualna Drzavina / single possessor	
P-70917048-00568-3	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land			MOTEL / MOTEL / MOTEL	2397	Tokë Ndërtimore - Shtëpi-Ndërtëse - / Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradëvinsko zemljište - Kuca- Zgrada - / Gradëvinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - House-Building - / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posezim individual / Individualna Drzavina / single possessor	



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-12813/2018
Kaçanik, 27.04.2018

Në bazë të nenit 17, 51.2 dhe 40.2 (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale, të, nenit 6.2 (f) lidhur me nenin 39.2 alineja 2 e Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-12813/18 prej datës 20.04.2018,, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 Prill 2018, mori këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE

1. Me këtë Vendim, formohet Komiteti për Shërbime Publike, i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut.
2. Komiteti për Shërbime Publike, përbëhet prej 5(pesë) anëtarëve nga radhët e Kuvendit të Komunës, duke reflektuar përfaqësimin politik në kuvend, dhe atë:

1. Hamid Guri	PDK	anëtar,
2. Lirije Shurdhani-Dema	PDK	anëtare,
3. Adnan Reka	AAK	anëtare,
4. Arlinda Rakoci-Raka	LDK	anëtare dhe
5. Afërdita Shehi	AAK	anëtare.
3. Kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këtij Komitetit.
4. Ky Komitet ka për detyrë të mbështesë dhe monitoroj punën e drejtorisë komunale për Shërbime Publike si dhe shërbimet publike në përgjithësi.
5. Funksionimi dhe kompensimi i këtij Komiteti do të rregullohet me akt nënligjor.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.
7. Pas aprovimit në Kuvend, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe 7 ditë Publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Shërbime Publike, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, MAPL dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kamal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipal Assambly

01Nr. 06-104-12769/2018
Kaçanik, 27. 04.2018

Në bazë të nenit 12.1 lidhur me nenin 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të Propozim Vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06-104/02-12769/18 -Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27 Prill 2018, mori këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT PËR GDHËNDJEN NË SHKËMB TË FIGURËS SË IDRIZ SEFERI –HEROIT KOMBËTAR, TË GRYKA E KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, i jepet PËLQIMI, FONDACIONIT, Idriz Seferi (FIS-i) për realizimin e projektit. Gdhendja në Shkëmb të Gryka e Kaçanikut, e heroit kombëtar, Idriz Seferit- simbolit të krenarisë kombëtare shqiptare, sipas projektit ideor III të prezantuar nga Këshilli organizativ i këtij fondacioni.
2. Organizatorët e Fondacioni, Idriz Seferi, janë të obliguar të marrin veprime paraprake lidhur me studimet e fizibilitetit dhe studimet tjera ashtu si e përcakton Ligji për Ndërtim, të përcaktojnë përmasat e gdhendjes në gurë të figurës së Idriz Seferit dhe si do të jetë dukja, parcelat e kadastrave dhe veprime të tjera të nevojshme dhe Planin Detal t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë) dhe Arkiva.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 07-104/01-11876/2018
Kaçanik, 27.04.2018

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17.(g) Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale, të, nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Projekt Planit të DESHP 07-104/01-11876/2018 prej datës 13.04.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 Prill 2018, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI PËR KOMUNËN E
KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Mbrojtjes nga Zjarri për Komunën e Kaçanikut, i propozuar nga Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike.
2. Në Planin e përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi janë përcaktuar objektivat që duhet ndërmarrë në rast të rreziqeve nga zjarri për parandalimin e tyre, me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve, mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë dhe të ambientit.
3. Plani i veprimit si në pikën 1. të këtij Vendimi është hartuar nga Grupi punues i përcaktuar nga Kryetari i Komunës, përmban gjithsej 60 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e Plani i Mbrojtjes nga Zjarri, do të kujdeset, Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike-Sektori për Emergjencë.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe 7 ditë Publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë – përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kamal Mërseli